

Kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Besa Ademi, në bazë të nenit 88 paragrafi (1) dhe (3) në lidhje me nenin 39 paragrafi (4) dhe (5) të Ligjit për gjykatat, nenit 13, nenit 112 nga Rregullorja gjyqësore, Programit të miratuar të punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për vitin 2022 03Su.nr.923/21 të datës 28.12.2021 dhe Rregullores së punës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut (“Gazeta Zyrtare e RMV” nr.14 të datës 20.01.2022), pas mendimit të dhënë paraprak për Orarin vjetor të punës së Gjykatës, në Seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut të datës 24.12.2021, më 26.01.2022, miratoi këtë:

ORAR VJETOR
të punës së Kryetarit dhe gjyqtarëve në Gjykatën Supreme të
Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022

I
ADMINISTRATA GJYQËSORE

A.I. Kryetarja e Gjykatës Besa Ademi do t'i realizojë punët nga pjesa e Administratës gjyqësore, do të organizojë punën, do të udhëheq dhe menaxhojë me Gjykatën.

Kryetarja e Gjykatës do ti realizojë punët dhe detyrat punuese për të cilat është kompetente në pajtim me Ligjin për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RM” nr.58/06, 62/06, 35/08 dhe 150/10, 83/18, 198/18 dhe 96/19), Ligjit për Këshillin gjyqësor të RMV “Gazeta zyrtare e RMV” nr.102/19 dhe Rregulloren gjyqësore, edhe atë:

- do të prezantojë Gjykatën,
- do të organizojë punën dhe do të ndërmerr masa për kryerjen në kohë dhe në rregull të punëve në Gjykatën dhe për sigurimin e zbatimit të Rregullores gjyqësore,
- do të veprojë për parashtresat, ankesat dhe propozimet e palëve dhe organeve tjera nga Regjistri UPP,
- do të veprojë për kërkesat për përjashtime të parashtruara nga gjyqtarët dhe nga palët nga Regjistri SU-IZZ,
- do të veprojë për lëndët nga regjistrat Su, Su01, Su03, Su04, Su05, Su-06, Su-Dov, Su-Str.Strog.DOV dhe
- do të udhëheq me Sektorin e veprave civile si Kryetare e Sektorit.

A.II. Për zëvendës të Kryetares së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut **Besa Ademi**, përcaktohet gjyqtarja **Cvetanka Periq**, e cila do ta zëvendësojë Kryetaren në mungesë të saj.

II

SEKTORI I VEPRAVE PENALE

B.I. Në Sektorin e veprave penale caktohen gjyqtarët:

1. **Cvetanka Periq - Kryetare**
2. **Dr. Xhemali Saiti - anëtar**
3. **Afrim Fidani - anëtar**
4. **Mirjana Llazarova Trajkovska - anëtare**
5. **Mr. Safet Kadrii - anëtar**

B.II. Për kryetare të Sektorit të veprave penale caktohet gjyqtarja **Cvetanka Periq**, kurse për zëvendës të saj caktohet gjyqtari **Mr. Safet Kadrii**.

B.III. Këshillat prej pesë gjyqtarëve të cilët do të veprojnë për të gjitha llojet e lëndëve në këtë sektor janë:

1. **Cvetanka Periq – Kryetare**
2. **Dr. Xhemali Saiti - anëtar**
3. **Afrim Fidani - anëtar**
4. **Mirjana Llazarova Trajkovska - anëtare**
5. **Mr. Safet Kadrii - anëtar**

B.IV. Këshillat prej tre gjyqtarëve Kryetari i këshillit do ti formojë nga gjyqtarët të cilët janë caktuar në këshillin prej pesë gjyqtarëve.

B.V. Në rast të pengesës dhe shkaqeve të tjera të arsyetuara të kryetarit të këshillit, për zëvendës të kryetarit të këshillit caktohet **gjyqtari Mr. Safet Kadrii**. Për zëvendës të një anëtari të këshillit në rast të pengesës ose për shkaqe tjera të arsyetuara, caktohen gjyqtarët **Mr. Faik Arslani, Jelica Kërstevska dhe Nake Georgieev**.

B.VI. Kryetari i Sektorit, përkatësisht Kryetarja e këshillit, gjyqtarja **Cvetanka Periq** nuk obligohet me lëndë.

B.VII-a. Në bazë të nenit 103 nga Ligji për drejtësi për fëmijë ("Gazeta zyrtare e RM" nr.148/13), formohet këshilli për fëmijë prej pesë gjyqtarëve me këtë përbërje:

1. **Cvetanka Periq - Kryetare**
2. **Dr. Xhemali Saiti - anëtar**
3. **Afrim Fidani - anëtar**
4. **Dr. Mirjana Llazarova Trajkovska - anëtar**
5. **Mr. Safet Kadrii - anëtar**

B.VII-b. Në rast të pengesës dhe për shkaqe tjera të arsyetuara të kryetarit të këshillit për zëvendës të kryetarit të këshillit caktohet

gjiqtari Mr. Safet Kadrii. Për zëvendës të një anëtari të këshillit në rast të pengesës ose për shkaqe tjera të arsyetuara, caktohet **gjiqtari Mr. Faik Arslani.**

B.VIII. Sipas nenit 21 paragrafi (1) të Ligjit për ndjekjen e komunikimeve ("Gazeta zyrtare e RM" nr.71/18), për gjiqtar që do të vendos për kërkesat e vendimmarrjes me urdhër për ndjekjen e komunikimeve, caktohet **gjiqtarja Besa Ademi**, ndërsa për zëvendëse të saj, **gjiqtarja Cvetanka Periq.**

B.IX. Sipas nenit 21 paragrafi (3) nga ligji i theksuar, formohet këshill prej 3 gjiqtarëve që do të vendos për ankesat e parashtruara kundër njoftimit për mospajtimin nga gjiqtari, në këtë përbërje:

1. **Dr. Mirjana L Lazarova Trajkovska - kryetare**
2. **Afrim Fidani - anëtar**
3. **Mr. Safet Kadrii - anëtar**

B.X. Në rast të pengesës dhe për shkaqe tjera të arsyetuara të kryetarit të këshillit, për zëvendës të kryetarit të këshillit caktohet **gjiqtari Mr. Safet Kadrii**, ndërsa për zëvendës të një anëtari të këshillit në rast të pengesës ose për shkaqe tjera arsyetuese, caktohet **gjiqtari Dr. Xhemali Saiti.**

Përgatitja e vendimeve, nënshkrimi, verifikimi dhe ekspedimi i të njëjtave të bëhet në afate të shënuara me ligj dhe në afat të arsyeshëm.

B.XI. Ditët për mbajtjen e seancave të këshillit për gjykim të lëndës i cakton kryetari i Sektorit.

III SEKTORI I VEPRAVE CIVILE

V.I. Në Sektorin e veprave civile caktohen gjiqtarët:

1. **Besa Ademi**
2. **Vasil Gërçev**
3. **Mirjana Radevska Stefkova**
4. **Vlladimir Stojanoski**
5. **Jelica Kërstevska**
6. **Snezhana Gjorgjievaska Zekirija**
7. **Isamedin Limani**
8. **Shpend Devaja**
9. **Mr. Snezhana Bajllozova**
10. **Nake Georgiev**
11. **Lidija Martinova**

V.II. Për kryetar të Sektorit të veprave civile caktohet gjiqtarja **Besa Ademi**, ndërsa për zëvendës të kryetarit gjiqtari **Shpend Devaja.**

V.III. Këshilli i parë prej pesë gjyqtarëve, që do të veprojnë për lëndët Rev1, Rev2 dhe Rev3, është si në vazhdim:

- 1. Mr. Snezhana Bajlozova – kryetare**
- 2. Vasil Gërçev - anëtar**
- 3. Vladimir Stojanoski - anëtar**
- 4. Jelica Kërstevska - anëtare**
- 5. Snezhana Gjorgjieska Zekirija - anëtare**

Kryetarja e këshillit, gjyqtarja **Mr. Snezhana Bajlozova** nuk obligohet me lëndë.

V.IV. Këshilli i dytë prej pesë gjyqtarëve që do të veprojnë për lëndët Rev1, Rev2 dhe Rev3 është si në vazhdim:

- 1. Shpend Devaja – kryetar**
- 2. Mirjana Radevska Stefkova – anëtare**
- 3. Isamedin Limani - anëtar**
- 4. Lidija Martinova - anëtare**
- 5. Nake Georgiev – anëtar**

Kryetari i këshillit, **gjyqtari Shpend Devaja** nuk obligohet me lëndë.

V.V. Në rast të mungesës dhe pengesës dhe për shkaqe tjera të arsyetuara kryetarët e këshillave do të zëvendësohen në mënyrë reciproke.

V.VI. Në rast të mungesës dhe pengesës për shkaqe tjera të arsyetuara të një anëtari të këshillit, zëvendësi i anëtarit do të caktohet në këtë mënyrë:

-për zëvendës të anëtarit të parë të këshillit të parë caktohet anëtari i parë i këshillit të dytë dhe anasjelltas.

-për zëvendës të anëtarit të dytë të këshillit të parë caktohet anëtari i dytë i këshillit të dytë dhe anasjelltas.

-për zëvendës të anëtarit të tretë të këshillit të parë caktohet anëtari i tretë i këshillit të dytë dhe anasjelltas.

-për zëvendës të anëtarit të katërt të këshillit të parë caktohet anëtari i katërt i këshillit të dytë dhe anasjelltas.

V.VII. Kryetarët e këshillave do të formojnë këshillat prej tre gjyqtarëve për procedimin e lëndëve të ndryshme civile “R” nga anëtarët e këshillave të tyre.

V.VIII. Përgatitja e vendimeve, nënshkrimi, verifikimi dhe ekspedimi i të njëjtëve të bëhet në afatet e shënuara me ligj dhe në afat të arsyeshëm.

V.IX. Ditët e mbajtjes së seancave të këshillit për gjykim të lëndës i cakton kryetari i Sektorit së bashku me Kryetarët e këshillave.

IV

SEKTORI PËR GJYKIM NË AFAT TË ARSYESHËM

C.I. Në këtë Sektor caktohen gjyqtarët:

1. Vasil Gërçev
2. Mirjana Radevska Stevkova
3. Vlladimir Stojanoski
4. Mr. Faik Arslani
5. Dr. Xhemali Saiti
6. Snezhana Gjorgjieska Zekirija
7. Isamedin Limani
8. Afrim Fidani
9. Dr. Mirjana LLazarova Trajkovska
10. Mr. Safet Kadrii
11. Nake Georgiev

C.II. Për kryetar të Sektorit për gjykim në afat të arsyeshëm caktohet gjyqtarja **Dr. Mirjana LLazarova Trajkovska**, ndërsa për zëvendëse të saj caktohet **Snezhana Gjorgjieska Zekirija**.

Sekretari i Sektorit dhe zëvendësi sipas nevojës caktohen për punë të lëndëve, me konstatimin e Kryetarëve të këshillave.

C.III. Këshilli i parë prej tre gjyqtarëve, që do të vendosin për kërkesat për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm në pajtim me Ligjin për gjykatat (neni 36) është si në vazhdim:

1. **Dr. Mirjana Liazarova Trajkovska - kryetare**
2. **Mr. Safet Kadrii - anëtar**
3. **Nake Georgiev - anëtar**

C.IV. Këshilli i dytë prej tre gjyqtarëve për vendimmarrjen e kërkesave për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm në pajtim me Ligjin për gjykatat (neni 36) është si në vazhdim:

1. **Dr. Xhemali Saiti – kryetar**
2. **Lidija Martinova - anëtare**
3. **Afrim Fidani - anëtar**

Kryetarët e këshillave, gjyqtarja **Dr. Mirjana LLazarova Trajkovska** dhe gjyqtari **Dr. Xhemali Saiti**, nuk obligohen me lëndë.

Në rast të mungesës dhe pengesës dhe për shkaqe tjera të arsyetuara kryetarët dhe anëtarët do të zëvendësohen në mënyrë reciproke.

C.V. Gjyqtarët e caktuar në Sektorin për gjykim në afat të arsyeshëm do të vendosin për lëndë nga të gjitha materiet.

C.VI. Për vendimmarrjen e ankesave kundër vendimeve të këshillit prej tre anëtarëve për kërkesat për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të

arsyeshëm në pajtim me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat (neni 36-a), caktohet **këshilli prej pesë gjyqtarëve** në këtë përbërje:

1. **Snezhana Gjorgjieska Zekirija - kryetare**
2. **Vasil Gërçev - anëtar**
3. **Mijana Radevska Stefkova - anëtare**
4. **Vlladimir Stojanoski - anëtar**
5. **Mr. Faik Arslani - anëtar**

C.VII. Kryetarja e këshillit gjyqtarja **Snezhana Gjorgjieska Zekirija** nuk obligohet me lëndë. Për zëvendës të kryetarit të këshillit caktohet gjyqtari **Vasil Gërçev**.

C.VIII. Në rast të mungesës dhe pengesës për shkaqe tjera të arsyetuara, për zëvendës të një anëtari caktohen gjyqtarët **Isamedin Limani dhe Cvetanka Periq**.

C. IX. Përgatitja e vendimeve, nënshkrimi, verifikimi dhe ekspedimi i të njëjtëve të bëhet në afatet e shënuara me ligj dhe në afat të arsyeshëm.

C. X. Ditët e mbajtjes së seancave të këshillit për gjykim të lëndës i cakton kryetari i Sektorit.

V

KËSHILLAT E SPECIALIZUARA

Ç.I. Për vendimmarrjen e ankesave kundër vendimeve të Gjykatës Administrative nga neni 62 të Ligjit për konteste administrative, me propozim për mbrojtje për shkak të veprimit të kundërligjshëm, **këshilli i parë** prej tre gjyqtarëve është si në vazhdim:

1. **Isamedin Limani – kryetar**
2. **Vlladimir Stojanoski - anëtar**
3. **Mr. Safet Kadrii - anëtar**

Ç.II. Për vendimmarrjen e ankesave kundër vendimeve të Gjykatës Administrative nga neni 62 të Ligjit për konteste administrative, me propozim për mbrojtje për shkak të veprimit kundërligjor, **këshilli i dytë** prej tre gjyqtarëve është si në vazhdim:

1. **Afrim Fidani – Kryetar**
2. **Vasil Gërçev - anëtar**
3. **Jelica Kërstevska - anëtare**

Ç.III. Në rast të mungesës dhe pengesës për shkaqe tjera të arsyetuara të Kryetarit ose një anëtarit të këshillit, për zëvendës të Kryetarit të këshillit përkatësisht një anëtarit të këshillit caktohen **gjyqtarët Snezhana Gjorgjieska Zekirija dhe Mr. Safet Kadrii**.

Ç.IV. Në pajtim me nenin 49 paragrafi (5) të Ligjit për këshillin gjyqësor, formohet këshill prej pesë gjyqtarëve, që do të vendos për ankesat e kandidatit që nuk është zgjedhur për gjyqtar, si në vazhdim:

1. **Mr. Faik Arslani - Kryetar**
2. **Vlladimir Stojanoski - anëtar**
3. **Jelica Krëstevska - anëtare**
4. **Mr. Safet Kadrii - anëtar**
5. **Nake Georgiev - anëtar**

Në rast të mungesës dhe pengesës për shkaqe tjera të arsyetuara të Kryetarit ose një anëtari të këshillit, për zëvendës të Kryetarit të këshillit caktohet **gjyqtari Dr. Xhemali Saiti**, ndërsa për zëvendës të një anëtari të këshillit caktohen **gjyqtarët Shpend Devaja dhe Mr. Snezhana Bajlozova**.

VI SEKTORI I PRAKTIKËS GJYQËSORE

E.I. Në këtë Sektor caktohen gjyqtarët si kryetarë të sektorëve:

1. **Besa Ademi**
2. **Mr. Snezhana Bajlozova**
3. **Cvetanka Periq**
4. **Dr. Mirjana L Lazarova Trajkovska**

Për Kryetare të Sektorit të praktikës gjyqësore, caktohet gjyqtarja **Mr. Snezhana Bajlozova**, ndërsa për zëvendës të kryetares gjyqtarja **Dr. Mirjana L Lazarova Trajkovska**.

VII SHPËRNDARJA E LËNDËVE

Në pajtim me nenin 174 nga Rregullorja gjyqësore, lëndët do të j' u jepen në punë gjyqtarëve me shpërndarjen automatike përmes Programit AKMIS.

Në pajtim me nenin 174 paragrafi (4) nga Rregullorja gjyqësore, me Vendim të veçantë, pjesë përbërës i këtij Orari vjetor për çdo sektor do të caktohet një nëpunës përgjegjës gjyqësor dhe zëvendës të tij për shpërndarjen automatike, sipas Orarit të punës së nëpunësve gjyqësor.

A r s y e t i m

Orari vjetor i punës është miratuar sipas dispozitave dhe rregullave të cituara ligjore, dhe duke marrë parasysh vëllimin dhe nevojat e punës në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Programin e miratuar të punës për vitin 2022, mendimin e siguruar nga Seanca e përgjithshme dhe numrin ekzistues të gjyqtarëve në Gjykatë.

Në fakt, në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në fillim të vitit 2022 funksionin e gjyqtarit e ushtrojnë vetëm 17 gjyqtarë, duke përfshirë edhe kryetarin e Gjykatës, në krahasim me vitin e kaluar. Kjo për arsye se, gjatë vitit 2021 është shkarkuar një gjyqtar i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut me numër 10-41/10 të datës 15.07.2021, një gjyqtar është larguar përkohësisht nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut deri në përfundimin e plotfuqishëm të procedurës për konstatimin e përgjegjësisë të gjyqtarit, e cila procedurë ende nuk ka përfunduar. Me aktvendim të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut gjyqtarës Emilija Ilievska i është konstatuar pushimi i funksionit të gjyqtarit në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut prej më 31.12.2021 deri më 31.01.2026.

Gjatë vitit në qoftë se paraqitet nevoja për rishpërndarjen e lëndëve për shkak të vëllimit të rritur të punës dhe për arsye tjera, ose në rastet nga neni 179 nga Rregullorja gjyqësore, Kryetari i Gjykatës do të miratojë ndryshime dhe plotësime të Orarit vjetor të punës për vitin 2022, që do të jenë pjesë përbërës të së njëjtit.

Sipas ndryshimeve në përbërjen e këshillave, lëndët të cilat u janë dhënë gjyqtarëve me shpërndarjen automatike, ndërsa të njëjtat nuk janë referuar ose nuk është miratuar vendim, automatikisht do të rishpërndahen sipas Rregullores gjyqësore.

Sipas ndryshimeve në përbërjen e këshillave, lëndët që gjenden në punë të gjyqtarët, por janë të referuara ose është miratuar vendim që të përfundohen në të njëjtat këshilla, përveç lëndëve të gjyqtarës Emilija Ilievska.

Ky orar hyn në fuqi nga dita e miratimit, ndërsa do të zbatohet pasi të bëhet i plotfuqishëm.

**ПРЕТСЕДАТЕЛ НА ВРХОВНИОТ СУД НА
РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
KRYETARJA E GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË SË VERIUT**

Besa Ademi

UDHËZIM: Sipas nenit 39 paragrafi (11) të Ligjit për gjykatat, kundër Orarit vjetor të punës për vitin 2022, gjyqtari mund të parashtrijë ankesë në afat prej 3-tre ditësh pas pranimit të së njëjtit.

Dorëzuar:

- Gjyqtarëve
- Administratorit gjyqësor
- udhëheqësve të sporteleve
- kontabilitetit
- Qendrës IT
- arkivit